

# KONTRATË SHITJE

(Kuotash të Shoqërisë)

Në Tiranë, sot më datë 09.05. 2023, në zyrën e shoqërisë "Bigalb Group" sh.p.k, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, në veçanti në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe të ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, lidhet kjo kontratë huaje midis palëve të mëposhtme:

**PALA E PARË: Z. Festim Meçe**, i biri Fejzos, i datëlindjes 07.09.1951, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 035866921 dhe nr personal F109070350, që këtu e në vijim. "**Shitësi**"

**PALA E DYTË: Z. Bahri Shaqiri**, i biri i Femiut, i datëlindjes 08.06.1970, lindur dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 034140492 dhe nr personal H00608054R, që këtu e në vijim "**Blerësi**"

## HYRJE

- A. Shoqërisa "BIG LIQENI" shpk, është person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKB më datë 13.06.2014, pajisur me nipt L44213602I, me seli në adresën *Korcë, Pogradec Lagjja nr 1, Rruga 10 Dëshmoret e Pojskes, pallati i ri FIDAI, kati 1*, me ortakë:
- |                                       |   |
|---------------------------------------|---|
| <b>2.1.1</b> Shoqëria "BIGALB GROUP": | Numri i Pjesëve 1 (një);<br>Pjesëmarrja në përqindje 51%; |
| <b>2.2.1</b> Z. Festim Meçe:          | Numri i Pjesëve 1 (një);<br>Pjesëmarrja në përqindje 49%  |
- B. Palët kanë rënë dakort që një pjesë të kuotave të zotëruara nga Shitësi, të kalojnë tek Blerësi mbas firmosjes së kësaj kontrate dhe kalimit të pagesës.
- C. Ortaku, Shoqëria "BIGALB GROUP" shpk, me vendimin Nr. 2 të datës 09.05.2023, në mënyrë të shprehur ka dhënë aprovimin e saj për tjetërsimin e kuotave

Duke vlerësuar bashkëpunimin dhe interesin e ndërsjellë, palët bien dakort për redaktimin e kësaj Kontrate Shitje si më poshtë:

## Neni 1

### Baza Ligjore

- 1.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, më posaçërisht Nenet 659 e vijues të tij;  
1.2 Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", më posaçërisht nenet 72-75 të tij.

## Neni 2

### Objekti

- 2.1 Shitësi do t'i shesë Blerësit, një pjesë të kuotave të tij, në masën në masën e 24% të kapitalit, nga totali prej 49% (dyzetë e nëntë për qind) që Shitësi zotëron në shoqërinë Big Liqeni.  
2.2 Mbas shitjes së kuotave, Shoqëria "BIG Liqeni" shpk, do të zotërohet nga ortakët në si më poshtë:

1. Shoqëria "BIGALB GROUP": Numri i Pjesëve 1 (një);  
Pjesëmarrja në përqindje 51% (pesëdhjetë e një për qind);
2. Z. Festim Meçe: Numri i Pjesëve 1 (një);  
Pjesëmarrja në përqindje 25% (njëzet e pesë për qind);
3. Z. Bahri Shaqiri: Numri i Pjesëve 1 (një);  
Pjesëmarrja në përqindje 24% (njëzet e katër për qind).

**Neni 3**  
**Afati**

**3.1** Afati i kalimit të këtyre kuotave do të jetë një 1 (një) muaj nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

**Neni 4**  
**Vlera e shitjes**

**4.1** Kuotat do të shiten me vlerën nominale prej 240,000 (dyqind e dyzetë mijë) lekë.

**Neni 5**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 5.1** Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me kuptimin dhe realizimin e kësaj kontrate, do ta zgjidhin me mirëkuptim.
- 5.2** Në rast se mosmarrëveshjet e mundshme nuk zgjidhen me mirëkuptim, secila nga palët mund t'i drejtohet për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.
- 5.3** Legjislacioni i zbatueshëm do të jetë legjislacioni shqiptar.

**Neni 6**  
**Të tjera**

- 6.1** Kontrata lexohet nga ne palët dhe pasi gjendet konform ligjit dhe vullnetit tonë të lirë, e nënshkruajmë atë rregullisht.
- 6.2** Kontrata redaktohet në 2 kopje, me fuqi të njejtë.
- 6.3** Bashkangjitur dokumentat:
  1. Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar të Shoqërisë "BIG LIQENI" shpk;
  2. Vendim Nr. 2, datë 09.05.2023 i Shoqërisë "BIG LIQENI" shpk;
  3. Dokumentat ID të palëve

**PALËT:**

**SHITËSI**  
Z. Festim Meçe



**BLERËSI**  
Z. Bahri Shaqiri

